



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME PLENARE E KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 22.02. 2011**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 22.02. 2011. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2011**

E martë, më 22 shkurt 2011, ora 15:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar përfaqësues të Zyrës Ndërkombëtare,
E nderuar euro – deputete Lunaçek,
I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Dell,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të zyrave diplomatike në Kosovë,
Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare,
Të nderuar të pranishëm të tjerë në këtë mbledhje,

Hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesën e grupit prej 50 deputetëve, me këtë rend dite:

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe
2. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Konstatohet se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë.

Ju njoftoj se me vendim të presidentit në detyrë, është bërë zëvendësimi i deputetit Ramush Haradinaj me deputetin Bali Muharremaj, nga subjekti politik i AAK-së. Deputetit të certifikuar i dëshiroj mirëseardhje dhe punë të mbarë dhe e ftoj ta nënshkruaj deklaratën e betimit.

Të nderuar deputetë,
Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, kandidat për President të Republikës së Kosovës është nominuar Behgjet Pacolli, aktualisht deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ftoj propozuesin që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë arsyetimin për kandidatin e nominuar për president. Ftoj deputetin Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë,
Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 36 dhe në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, Kreu VIII, neni 27, paragrafi 3, Koalicioni qeverisës me nënshkrime të mbi 67 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kandidat për President të Republikës së Kosovës propozon zotëri Behgjet Pacollin. Propozimit i është bashkangjitur dokumentacioni i përcaktuar me kushtetutë dhe me rregullore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për verifikimin e kushteve të kandidatit të nominuar për president, të parapara me Kushtetutë dhe me Ligjin për President të Republikës së Kosovës, propozoj që Kuvendi të autorizojë Komisionin e përkohshëm për verifikimin e mandateve, të formuar nga Kuvendi në mbledhjen konstituive.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për autorizimin e komisionit. Sekretaria, i numëroni votat! Kush është “kundër”? “abstenim”? 2 abstenime. Konstatoj se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime Kuvendi autorizoi Komisionin e përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve për konstatimin e plotësimit të kushteve të kandidatit për president dhe Kuvendit i paraqet raportin.

Kërkoj nga Komisioni në përbërje:

Idriz Vehapi, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike,
Armend Zemaj, i propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike.
Alma Lama, nga “Vetëvendosja”,
Teuta Haxhiu, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës,
Myzejene Selmani, nga Koalicioni për Kosovë të Re,
Jelena Bontiq, nga Grupi Parlamentar i SLS,së, dhe
Albert Kinolli, nga Grupi Parlamentar “6+”,

që menjëherë të mbliidhet në sallën numër 10 dhe ta kryejë detyrën e vet, kurse ne marrim një pauzë prej 10 minutash.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Vazhdojmë punën. Ftoj kryesuesin e Komisionit, zotin Idriz Vehapi, që Kuvendin ta njoftojë me konstatimet e komisionit.

IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Të nderuar të pranishëm,

Komisioni i përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve

Raport për verifikimin e kushteve të kandidatit të nominuar për president, zotit Behgjet Pacolli

Komisioni i përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve, në pajtim me vendimin e seancës plenare të datës 22 shkurt 2011, shqyrtoi dokumentacionin e kandidatit të nominuar për President të Republikës së Kosovës, zotit Behgjet Pacolli, lidhur me plotësimin e kushteve të parapara në Kushtetutën dhe me Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, konstatoi se kandidati i nominuar për President të Republikës së Kosovës, zoti Behgjet Pacolli i plotëson kushtet e parapara me Kushtetutën dhe me Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 22 shkurt 2011
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Prezent kemi 93 deputetë.

Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Nuk ka. Fjalën e ka Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ose në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka vendosur që të mos marrë pjesë në procesin e votimit të Qeverisë dhe të Presidentit të Republikës së Kosovës. Grupi Parlamentar i LDK-së konsideron se këto zgjedhje nuk mund të prodhojnë një qeveri dhe një president me mandat të plotë për arsye se zgjedhjet kanë qenë të pandershme, jodemokratike dhe të manipuluar.

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se edhe procedurat e zhvilluara pranë organeve të parapara me ligj, KQZ, PZAT dhe Gjykatë Supreme nuk kanë arritur të krijojnë legjitimitetin e këtyre zgjedhjeve duke pasur parasysh përmasat e gjëra dhe mënyrat e shumta të manipulimeve në tërë territorin e Kosovës. Burim i këtyre problemeve dhe dobësive, përpos manipulimeve nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Qeveria e shkarkuar, kanë qenë edhe sistemi zgjedhor dhe legjislacioni në fuqi, që duhet të ndryshohen sa më shpejt dhe të hapen rrugë për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta, të cilat do t'ua kthenin legjitimitetin dhe besueshmërinë e institucioneve kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e koalicionit për Qeverinë dhe për Presidentin e Republikës së Kosovës nuk është marrë mbi baza të interesave të vendit dhe të qeverisjes së mirë, por mbi bazë të kërkesave dhe të ambicieve personale. Dobësitë e manifestuara në këtë zgjedhje e vënë në dyshim legjitimitetin, qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e plotë të institucioneve që dalin nga këto zgjedhje.

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se mundësia më e mirë për dalje nga kjo situatë është një marrëveshje politike ndërmjet subjekteve parlamentare, me një agjendë të qartë pune që do të bëhet deri në zgjedhjet e ardhshme, të bëhet regjistrimi i popullsisë, të saktësohen listat e zgjedhësve, të ndryshohet sistemi zgjedhor, të ndryshohet Ligji zgjedhor, ndryshohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, atëherë propozohet mbajtja e zgjedhjeve parlamentare demokratike vitin e ardhshëm, të cilat do ta sigurojnë legjitimitetin demokratik të brendshëm dhe ndërkombëtar të institucioneve të dala nga vota e qytetarit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” kush e do fjalën? Deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
Deputet të Kuvendit të Kosovës,

Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta votojë Behgjet Pacollin për president të Republikës. Konsiderojmë që ai është i papërshtatshëm edhe politikisht, edhe personalisht për të shërbyer si president i vendit.

Behgjet Pacolli, si kryetar i AKR-së dhe njëkohësisht deputet i Kuvendit të Kosovës në legjislaturën e kaluar, ka qenë i pranishëm, së bashku me shumë të tjerë, në të gjitha ato momente kur ky kuvend miratonte ligje të Planit të Ahtisaarit, pa debat e në mënyrë të përsheptuar jodemokratike dhe aprovonte flamuj shkombëtarizues e himne pa tekst. Gjatë tërë kësaj kohe as Pacolli, e as partia e tij nuk e kanë bërë as kundërshtimin më të vogël ndaj kësaj mënyre absolutisht jopolitike dhe jodemokratike të funksionimit të këtij Kuvendi. Ky moskundërshtim e bën Pacollin dhe të tjerët si ai, një njeri joparimor, që nuk e çanë kokën fare për zhvillimin politik të vendit. Pra, që e çan kokën vetëm për interesat e ngushta personale.

Behgjet Pacolli, dhe AKR-ja e tij, gjatë tërë legjislaturës së kaluar kanë funksionuar më shumë si shërbim i Hashim Thaçit dhe i qëllimeve të tij politike, se sa si opozitë, çfarë formalisht ishte. Tërë qenia politike e Behgjet Pacollit në institucionet e Kosovës na është paraqitur si vazhdimësi e mendësisë dhe praktikës politike të Hashim Thaçit. Pacolli e ndihmonte politikisht Thaçin, e Thaçi e shpërblente Pacollin me tendere (p.sh. Pacolli i mori nga Thaçi 15 milionë euro për renovimin e Pallatit të Shtypit). Ishte ky Pacolli ai që ia mundësoi Hashim Thaçit zgjedhjet e jashtëzakonshme në një mot të keq, zgjedhje këto të përsheptuara dhe të organizuara si mos më keq, në momentin kur Thaçi dëshironte këso zgjedhjes, por nuk dëshironte që t’i shkaktonte ato vet. Kjo ndodhi më 2 nëntor të vitit të kaluar, siç jeni në dijeni të gjithë ju. Thaçit i nevojitej një Pacoll dhe një AKR që e inskenojnë mocionin e mosbesimit, në mënyrë që ai të arsyetohej se rrëzimin e qeverisë po e bën Kuvendi e jo ai vet. E tash Thaçi po ia shpërblen këtë ndihmë Pacollit, duke e kandiduar atë për president të vendit.

Ky duet politik – Thaçi e Pacolli janë të përkryer për njëri - tjetrin. Njëri e përdor politikën për t’u pasuruar, ndërkohë që tjetri e përdor pasurinë për t’u bërë politikan. Meqenëse asnjëri prej tyre nuk janë në politikë për të mirën e Kosovës, ata të dy së bashku janë e keqja e Kosovës si në rrafshin politik, ashtu edhe në atë ekonomik. Ky koalicion i arritur tash së fundi, ku pjesa më e rëndësishme e pazarit është posti i

presidentit të vendit, është koalicion i negociatave me Serbinë dhe koalicion i vazhdimit të privatizimit shumë të dëmshëm të ndërmarrjeve publike dhe të keqpërdorimit të parasë publike. Dikush mund të thotë se këtë duhet ta shohim në vazhdim, mirëpo përvoja që e kemi pasur me këta dy persona dhe deklaratimet publike na tregojnë qartë se te këta asgjë nuk ka ndryshuar. Negociatat me Serbinë janë të padrejta për Kosovën, të dëmshme për të tashmen e saj, të rrezikshme për të ardhmen e saj dhe gjithsesi janë të pabarabarta. Ato do ta thellojnë edhe më tutje ndarjen e brendshme të Kosovës në vija etnike, duke e avancuar dhe forcuar përmes legalizimit ndërhyrjen e Serbisë në Kosovë, ndërkohë që privatizimi e projektet tjera kapitale të qeverisë së kaluar e të këtij koalicioni që po na paraqitet këtu, do ta vazhdojnë edhe më tutje stërkeqjen dhe mjerimin ekonomik e social ku na kanë katandisur. Dhe për të gjitha këto do të jenë përgjegjës Thaçi e Pacolli dhe të gjithë të tjerët si ata.

Behgjet Pacolli publikisht e ka deklaruar se shikon kah Serbia dhe qëndron me shpinë kah Shqipëria. Pra, është saktësisht e kundërta e vullnetit politik të popullit të Kosovës dhe e programit të “Vetëvendosjes”. Por është e njëjta anë e së njëjtës medalje, që quhet Hashim Thaçi. Edhe ky ka treguar një vullnet të pashoq që të negociojë me Serbinë, ndërkohë që me politikën dhe projektet e tij gjatë qeverisjes ka mëtuar të na shkombëtarizojë dhe të na largojë sa më shumë nga Shqipëria. Këta të dy janë në anën e kundërt të asaj se çka synon populli ynë dhe për çka është përpjekur ai.

Pacolli suksesin më të madh afarist e ka arritur në marrëdhëniet e tij me Rusinë. Pacolli është pasuruar në Rusi, ndërkohë që e njëjta Rusi synon ta fuqizojë Serbinë. Serbia si shtet ia ka borxh tërë ekzistencën e saj politike Rusisë, e Rusia është kundërshtari më i madh aktual e historik i së drejtës së shqiptarëve për vetëvendosje.

Pacolli është biznesmen. Prandaj marrëveshja e tij për koalicion është vetëm pazar, dhe nuk ka asgjë politike në të. Në këtë drejtim, Pacolli e ka blerë postin e Kryetarit. Si biznesmen që është, ai tregoi gatishmëri që t'i hyjë kësaj marrëveshjeje transakcioni pavarësisht kostos së saj. Për të posti i presidentit të vendit duket të jetë një investim i rëndësishëm, nga i cili pret kthime të mira. Por biznismen është edhe Thaçi. Ai e bleu Pacollin dhe AKR-në, në mënyrë që ta sigurojë edhe për ca kohë postin e kryeministrit. Edhe ky këtë e pa si investim dhe edhe ky pret kthime nga ky investim. Ne jemi të vetëdijshëm se çfarëdo qoftë pazari dhe pavarësisht se sa do të fitojnë këta dy persona nga ky pazar, e tërë kjo marrëveshje afariste në fund do t'i faturohet qytetarit të Kosovës. Do t'i faturohet si humbje e një pjese të territorit në të cilën Serbia po e konsolidon pushtetin e saj; do t'i faturohet si humbje e pasurisë kombëtare të cilat po tjetërsohen përmes privatizimit; do t'i faturohet si tatim i paguar kot për shkak se paraja publike do të keqpërdoret nga nënshkruesit e kësaj marrëveshjeje; do t'i faturohet si stërkeqje politike

për shkak se përmes kësaj marrëveshje po sulmohet rëndë mundësia e zhvillimit të demokracisë në Kosovë.

Ne jemi të vetëdijshëm për rëndësinë që kanë institucionet dhe për momentin në të cilin gjendemi. Por jemi po ashtu të vetëdijshëm që këtë gjendje e kanë sjellë Thaçi dhe Pacolli. Sanimi i gjendjes nuk mund të vije përmes shkaktarit të saj. Shkaku e kushtëzon gjendjen. E garantimi i jetëgjatësisë së shkaku është garantim i jetëgjatësisë së pasojës së tij të cilën e jetojnë qytetarët përditë. Ne jemi kundër kësaj gjendje të rëndë dhe kundër synimeve të Thaçit e të Pacollit për ta rënduar atë. Prandaj nuk do ta votojmë Pacollin. Me qenë se këta të dy janë kështu dhe situata është e tillë, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk mori pjesë në votimin për Komisionin për verifikim të mandateve dhe Alma Lama nuk mori pjesë në punën e këtij komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetët që donë të jenë pjesë e debatit, le të paraqiten me shkrim.

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk do të marrë pjesë në votimin për president, as për Qeverinë e Kosovës dhe ka vendosur të mos jetë prezent gjatë kohës së votimit.

Ky vendim vjen për shumë arsye, mendoj se shumë u thanë, por edhe më tepër nuk janë thanë pse zoti Pacolli nuk duhet të jetë kryetar i Kosovës dhe pse zoti Thaçi nuk duhet të jetë kryeministër i Kosovës. Nuk mendojmë se është në interes të vendit që një gjë e tillë të ndodhë dhe po ashtu mendojmë se Kosova ka zgjidhje kushtetuese për të dalë nga kjo situatë. Përfundimisht, ne si deputetë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të qytetarëve të Kosovës nuk do të jemi dëshmitarë të një marrëveshjeje të tillë dhe të një qeverisjeje të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, e do dikush fjalën? Jo.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, e do dikush fjalën? Deputeti Slobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se, gospodine predsedniče!

Poštovane kolege, narodni poslanici,

Uvaženi predstavnici diplomatskog kora,

Gosti, građani Kosova,

Samostalna liberalna stranka je stranka rešenja, a ne problema. Samostalna liberalna stranka ima jedan motiv zašto je danas ovde, a to je ne samo dobro srpskoj zajednici, nego svakom građaninu Kosova. Svesti smo činjenice da svaka izgovorena reč sa ove

govornice ima posebnu težinu, a još veću težinu ima reč pripadnika manjinskih zajednica, gotovo Srpske zajednice. Poštujemo uvažene kolege koji su i „protiv“, poštujemo i one koji su „za“.

Mi želimo da budemo u službi građana koji su nas glasali, imamo tu odgovornost. Iz te odgovornosti Poslanički klub Samostalne liberalne strane, koji broj 12 poslanika, želi da da priliku ovom parlamentu da izabere institucije ne zbog pojedinaca, nego zbog obaveza koje su nam dali naši građani ta ih rešavamo. Čeka nas puno izazova. Možda nije na meni da ja o tome pričam, ali ja kao odgovoran čovek, predsednik stranke koju krasí ne popularizam, nego odgovornost, u ime ovih 12 poslanika želimo da damo priliku kandidatu za predsednika Kosova, da mi odlučimo da li će biti izabran. Još jednom naš je motiv da se formiraju institucije sa kojima trebamo da pomognemo građanima koji su nas birali. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, kush e do fjalën? Deputeti Mahir Yagcilar e ka fjalën.

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke u nisur nga nevoja për krijimin e institucioneve të Kosovës, Grupi “6+” e përkrah zotin Behgjet Pacollin për president të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Me grupe parlamentare më s’kemi. Për diskutim kemi edhe dy deputetë. Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta, le të përgatitet deputeti Liburn Aliu.

AGIM KULETA: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Vendi ynë sot ndodhet para një sfide të vërtetë politike dhe morale. Sot, përmes një qëndrimi të cilin do ta mbajmë këtu lidhur me zgjedhjen e presidentit të vendit, do ta përcaktojmë shkallën e vetëdijes sonë si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës. Këta qytetarë, përmes votës së tyre kanë shprehur një shkallë shumë të lartë të vetëdijes në lidhje me kandidatin e propozuar. Na mbetet ne të dëshmojmë a do të mund të qëndrojmë në nivelin e tyre.

Si kandidat për President të Republikës së Kosovës për 5 vitet e ardhshme sot u propozua Behxhet Pacolli.

Neni 83 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh që presidenti përfaqëson unitetin e popullit, ndërsa neni 84, pika 10 parasheh kompetencën e presidentit për ta udhëhequr politikën e jashtme.

A është kandidati i propozuar i përshtatshëm për president, kur kemi parasysh qoftë edhe vetëm këta dy komponentë: njëri kushtetues, tjetri politik?

Në radhë të parë, duke qenë se është figura më kontradiktore dhe më jo bashkuese në skenën politike të Kosovës; duke qenë se nuk përbën përfaqësim të një konsensusi shoqëror, por është produkt i pazarllëqeve midis dy partive, – ky kandidat asnjëherë nuk do të mund ta përfaqësojë unitetin e popullit. Prandaj, zgjedhja e tij do thoshte mospërmbushje e një obligimi kushtetues.

Në radhë të dytë, duke qenë se është një person me kredibilitet ndërkombëtar të kontestuar; duke qenë një person me interesa personale, të biznesit dhe me preferenca politike të orientuara kah ato vende, si pasojë e politikës së të cilave ne përballemi edhe sot e kësaj dite me vështirësi politike e ekonomike; duke qenë se ky njeri nesër, si president, këto interesa e preferenca personale do t'i ngritë në nivel institucioni shtetëror, ky kandidat asnjëherë nuk do të mund t'i përfaqësojë orientimet dhe interesat e vërteta politike të vendit tonë.

Askush nga ne, jam i sigurt, nuk është kundër orientimeve e preferencave personale të tij, por gjithashtu jam shumë i sigurt, se të gjithë ne së bashku refuzojmë të pranojmë që edhe orientimi politik kombëtar i vendit tonë të bëhet viktimë e këtyre orientimeve.

Deri sot kemi pasur një qeverisje që vazhdimisht është dyshuar për korrupsion në nivel kombëtar. Tani kësaj strukture po synohet t'i shtohet një president, të cilit mund t'i ngrihen akuza për shpëlarje parash e krime tjera ekonomike në nivel ndërkombëtar. Imagjinojeni, ju lutem, zonja e zotërinj, perspektivën e një vendi kaq të vogël me probleme kaq të mëdha e me një udhëheqje kaq problematike.

Është keq që ky vend të mbetet edhe për një kohë të shkurtër pa president, por është padurueshëm keq që ky vend për një kohë të gjatë të mbetet peng i një presidenti të keq.

Zonja dhe zotërinj,

Udhëheqësit e vendit, sado të fuqishëm qofshin në destruktivitetin e tyre, një ditë do të shkojnë. Ata që do të mbeten këtu do të jenë qytetarët dhe vuajtja që ata e kanë trashëguar nga këta udhëheqës të padenjë. Prandaj, ne, si deputetë të Lëvizjes për Bashkim, duke qenë kundër zgjedhjes së Behxhet Pacollit për president të Kosovës, nga këtu i bëjmë thirrje anës më të mirë të natyrës njerëzore të të gjithë deputetëve, që kur të vendosin, ta kenë parasysh një gjë: ta marrin një vendim për të cilin nuk do të kishin nevojë kurrë të pendoheshin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu. Është diskutuesi i fundit.

LIBURN ALIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Ne deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, të kaluarën e Behgjet Pacollit nuk mund ta tejkalojmë pasi që kjo e kaluar bie në kundërshtim të plotë me luftën dhe përpjekjet çlirimtare të popullit tonë. Bie në kundërshtim të plotë me përpjekjet për bashkim kombëtar, me përpjekjet për një jetë të sigurt për gjeneratat që vinë. Pra, ne nuk

mund ta tejkalojmë fare këtë të kaluar, po ashtu ne nuk mund ta pranojmë edhe të tashmen e Behgjet Pacollit, e po ashtu edhe të ardhmen e tij si president nuk do ta dëshirojmë.

Prandaj, me qenë se për kundërshtimin e tij nuk na duket e mjaftueshme vota kundër, ne do ta lëshojmë sallën, nuk duam të jemi të pranishëm këtu për atë njeri për të cilin besojmë që nuk duhej të ishte i pranishëm këtu.

(Deputetët e LDK-së, të “Vetëvendosjes” dhe të AAK-së e braktisën mbledhjen dhe nuk morën pjesë në procesin e votimit)

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj me procedurat për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Realisht, është dashtë dikush të flasë, por megjithatë pasi ju s’po flisni, unë po vazhdoj me procedura, se kjo gjendje në sallë, kështu siç është, nuk na nderon as neve, as kandidatët që do të vazhdojmë t’i zgjedhim.

Ju njoftoj me procedurat për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi me votim të fshehtë. Zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat e votave të deputetëve të Kuvendit. Nëse asnjë kandidat nuk i merr dy të tretat (e tani kemi vetëm një kandidat) të votave në dy votimet e para, zhvillohet votimi i tretë mes dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave në votimin e dytë. Kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve në votimin e tretë, zgjedhet president i Republikës së Kosovës. Nëse edhe në votimin e tretë asnjë nga kandidatët nuk zgjedhet President i Republikës së Kosovës, Kuvendi shpërndahet. Zgjedhjet e reja për Kuvend bëhen brenda 45 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. Mandati i presidentit është 5 vjet. Meqë zgjedhja e presidentit bëhet me votim të fshehtë, kjo nënkupton krijimin e një Komisioni votues nga përbërja e deputetëve me mbështetjen administrative teknike të Administratës së Kuvendit. Andaj, ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Ftoj një deputet të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ta japë emrin e kandidatit. Deputeti Enver Hoxhaj e ka fjalën.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, shumë!

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Dua ta propozoj nga Partia Demokratike e Kosovës zotin Memli Krasniqi, si anëtarë të komisionit.

KRYETARI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike nuk është prezent. Grupi i “Vetëvendosjes” nuk është prezent. Grupi i AAK-së, nuk është prezent. Ftoj shefin e Grupit të Koalicionit AKR, PD PSD, PPI, PK, PNDSH dhe PGJK, Ibrahim Makollin.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë nuk mora pjesë në debatin e mëhershëm, sepse nuk ka qenë praktikë në këtë Kuvend dhe nuk është praktikë në demokracitë parlamentare...

KRYETARI: Debati u krye, të lutem, po vazhdo!

IBRAHIM MAKOLLI: ...që të debatohet, që të ketë debat në zgjedhjen e presidentit. Është e përcaktuar Kushtetuta dhe Rregullorja e punës, e cila nuk parasheh debat në zgjedhjen e presidentit të vendit, parash votim “për”, “kundër” ose abstenim. Megjithatë, faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar i Koalicionit AKR, PD, PSD dhe të tjera, e propozojmë deputeten Myzejene Selmani. Faleminderit!

KRYETARI: Për debat ka vendosur Kryesia dhe me Rregullore të punës e keni që e interpreton Kryetari i Kuvendit të Kosovës, kështu që duhet të jetë e qartë kjo, vetë salla po flet a është dashur këtë debat a s’është dashur të ketë debat.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Slobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Poslanička Grupa Samostalne liberalne strane daje kandidata Jelenu Bontiq.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Mahir Yagcilar e ka fjalën.

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+” e propozojmë deputetin Duda Balje.

KRYETARI: Faleminderit!

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për emërimin e anëtarëve të Komisionit votues. Kush është “për”? A ka “kundër”? A ka abstenime?

Në sallë kemi 67 deputetë. Kanë votuar të gjithë, “kundër” s’ka, “abstenime” s’ka. Konstatohet se Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. Presim 5 minuta derisa teknika të jetë gati.

Ftoj anëtarët e komisionit që t’i zënë vendet e tyre.

Vazhdojmë me punën: Adem Grabovci, Aferdita Berisha – Shaqiri, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Agim Çeku, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Sylja, Bahri Thaçi, Bajram Rexhepi, Bali Muharemaj, Bedri Hamza, Behar Selimi, Behgjet Pacolli, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj – Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Enver Hoxhaj, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Ferid Agani, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca,

Në votim kanë marrë pjesë 67 deputetë,
“Për” kanë votuar 54 deputetë,
“Kundër” kanë votuar 11 deputetë,
Të pavlefshme janë dy fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit dhe në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se duhet të përsëritet votimi për raundin e dytë sipas neneve të cekura të Kushtetutës dhe të Rregullores së Punës.

KRYETARI: Le të ulët komisioni në vendet e tyre dhe e lus Administratën t’i përgatitë fletëvotimet për radhën e dytë të votimit.

Në vazhdim, fillojmë me votimin e dytë. Ftoj deputetët që të kthehen në sallë. Vazhdojmë.

Adem Grabovci, Afërdita Berisha-Shaqiri, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Agim Çeku, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Syla, Bahri Thaçi, Bajram Rexhepi, Bali Muharremaj, Bedri Hamza, Behar Selimi, Behgjet Pacolli, Bekim Haxhiu, Biserka Kostić, Blerim Shala, Blerta Deliu, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kada-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilia Rexhepi, Enis Kervan, Enver Hoxhaj, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Ferid Agani, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Gora Marinković, Hajredin Kuçi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hashim Thaçi, Hashim Deshishku, Hashime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Ibrahim Makolli, Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi...

XHAVIT HALITI:

Jasmina Živković, Jelena Bontić, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Lutfi Haziri, Lutfi Zharku, Mahir Yagcilar, Memli Krasniqi, Mimoza Kusari-Lila, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murselj Haljilji, Muzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Nekibe Kelmendi, Nenad Rašić, Petar Miletić, Rada Trajković, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Ldrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadergjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa, Saša Đokić, Saša Rašić, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Slobodan Petrović, Sreten Ivanović, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Savić, Vesna Mikić, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Vlora Çitaku, Xhevahire Izmaku, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti, Xhavit Haliti.

Lus Komisionin që ta raportojë numrin e saktë të votuesve dhe të procedojë me votimin.

Tash numërojmë votat “për”, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62.....

Vota “kundër” janë: 1, 2, 3, 4.

Vota të pavlefshme: 1.

Të nderuar deputetë, të nderuar mysafirë,
Komisioni votues për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, raporton për rezultatin e votimit për zgjedhjen e presidentit.

Komisioni votues, pas votimit të fshehtë në rrethin e tretë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur sot me 22 shkurt 2011, konstaton si vijon:

Rezultati i votimit për kandidatin për president, zotin Behgjet Pacolli, është si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 67 deputetë,
“Për” kanë votuar 62 deputetë,
“Kundër” kanë votuar 4 deputetë,
Dhe, i pavlefshëm është 1 fletëvotim.

Në bazë të rezultateve të votimit dhe në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se zotëri Behgjet Pacolli është zgjedhur President i Republikës së Kosovës. Urime!

KRYETARI I KUVENDIT: Pauza ishte e suksesshme!

Ftoj presidentin e porsazgjedhur të Kosovës, Behgjet Pacollin, që të bëjë betimin para deputetëve të Kuvendit. Fjalën e ke!

PRESIDENTI BEHGJET PACOLLI: ”Betohem se tërë fuqinë time do t’ia kushtoj ruajtjes së pavarësisë, të sovranitetit dhe të integritetit territorial të Republikës së Kosovës, sigurimit të lirive dhe të drejtave njerëzore e qytetare, respektimit dhe mbrojtjes së Kushtetutës dhe të ligjeve, ruajtjes së paqes dhe të mirëqenies të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe me ndërgjegje e përgjegjësi do t’i kryej të gjitha detyrimet e mia.”

Betohem para jush!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Mund ta vazhdoni një fjalë rasti, nëse e keni të përgatitur.

PRESIDENTI BEHGJET PACOLLI:

Të nderuar qytetarë të Kosovës,
I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,

I nderuar kandidat për Kryeministër të Kosovës, zoti Hashim Thaçi,
Të nderuar deputetë,
E nderuara familje Rugova,
E nderuara familje Jashari,
Të nderuara familje Haradinaj, Pajaziti dhe të gjitha familjet e tjera të çmuara të
dëshmorëve tanë,
Të nderuar përfaqësues të korit diplomatik në Kosovë,
Të nderuar pjesëmarrës e mysafirë,

Sot është një ditë e madhe, për mua fillon sfida e radhës me plot përgjegjësi.
Ju, të dashur deputetë, më zgjodhët mua për të vazhduar rrugën për përkryerjen e vizionit
të Presidentit historik, dr. Ibrahim Rugovës, për të plotësuar amanetin e heronjve tanë,
komandantit historik, Adem Jasharit dhe gjithë të tjerëve që ranë për shtetin e pavarur të
Kosovës.

Falënderoj presidentin e Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiun dhe ushtruesin e këtij
postit, dr. Jakup Krasniqin, për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në këtë detyrë.

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Sot ndihem i përlurur para jush dhe ndiej se nuk më mjafton fjala që të përshkruaj këtë
moment.

Nuk ekziston ndjenjë më e mirë se të fitosh besimin e përfaqësuesve të popullit, që t'i
shërbesh popullit dhe vendit tënd.

Unë jam i emocionuar por, nga ana tjetër, shumë i përgatitur që këtë besim që m'u dha
sot ta arsyetoj me dinjitet, me përgjegjësi, me gjithë energjinë, time, me dijen dhe qenien
time.

Jam krenar që jam njëri nga ju, i lindur dhe i rritur në mjediset e një familje tipike të
Kosovës, domosdoshmëria më shtyu të ballafaqohem me sfidat e jetës të civilizuar në
Perëndim, jetë kjo jo e lehtë për mua. Gjatë rrugëtimit tim, shpeshherë jam rrëzuar, por
gjithmonë jam ngritur dhe kam vazhduar ende më i fortë.

Ky rrugëtim më solli edhe suksese, me të cilat unë sot krenohem. Këto suksese i kam
arritur me punë të ndershme. Këto suksese janë sukseset e mia, të bashkëpunëtorëve të
mi, farefisit tim dhe familjeve të bashkëpunëtorëve të mi. Këto sfida dhe suksese të
arritura në Perëndim duhej të plotësoheshin një ditë me arritjet e vendit tim, Kosovës.

Unë u ktheva në Kosovë dhe e kuptova se këtu e kam vendin, në mesin e njerëzve të mi.
Këtu zemra ime rreh ndryshe, këtu i gëzohem tokës dhe diellit, më gëzon çdo gjë këtu
dhe më fascinon Perëndimi. Perëndimi është prej nga erdha unë dhe Perëndimi është
rruga, të cilës ia ka mësuar Kosova jonë.

I falënderoj miqtë tanë perëndimorë, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës,

Bashkësinë Evropiane, për ndihmën e madhe dhe kontributin që vazhdojnë dhe kontribuojnë për ndërtimin dhe forcimin e shtetit demokratik të Kosovës, për të gjithë qytetarët e saj, për shqiptarët, za srbe, tyrkler için, za Bošnjake i Crnogorce, për romët, ashkalinjtë dhe gjithë të tjerët.

Kosova ka fituar pavarësinë, lirinë dhe ndërton barazinë, tani po ndërtojmë shtetin. Këto arritje i synuam të gjithë dhe punuam me aq sa ditëm dhe mundëm, por ende jemi larg prej të qenit të kënaqur me arritjet tona e arritur e veçantë e shtetit të ri të Kosovës është njohja nga 75 shtete të botës, të cilat unë sot, prej këtu, i falënderoj në emër të popullit të Kosovës.

Kosova, sot po ballafaqohet me sfidat më të mëdha që nga çlirimi i saj. Ato janë të shumta dhe do të jenë përgjegjësi e funksionit tim që më besuat sot.

Përpjekjet e kosovarëve për një të ardhme më të mirë, janë virtyt i kosovarëve, jo dobësi. Asnjëherë nuk iu jemi dorëzuar sfidave dhe vështirësive, prandaj, përpjekjet tona për të forcuar institucionet dhe një Kosovë ndryshe, duhet të trajtohen si virtyt dhe domosdoshmëri e kohës në të cilën ne jetojmë.

Ishim dëshmitarë të përfoljeve, akuzave, etiketimeve të përmasave globale të drejtuara shtetit të Kosovës dhe njerëzve të saj. Por, të dashur deputetë, ju garantoj se kjo nuk është asgjë e jashtëzakonshme, e njëjta ka ndodhur edhe diku tjetër.

Në procesin e pavarësimit të Kosovës ndodhen veprime të jashtëzakonshme, si të njerëzve të Kosovës, ashtu edhe të ndërkombëtarëve, veprime këto në të cilat u përqendrua edhe opinioni botëror. Pavarësia e Kosovës ishte një storie e suksesit; përvoja ime më ka bindur se sukseksi mund nganjëherë edhe të mos falet. Kosova dhe njerëzit e saj shënuan një sukses, shënuan, historinë e shtetit më të ri në botë.

Sot, unë kam marrë një detyrim jo të lehtë, kam zgjedhur pajtimin dhe angazhimin kundrejt konfliktit dhe pasivitetit, kam zgjedhur të punoj dhe angazhohem në këtë rrugë të domosdoshme për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Nuk e them se dikush tjetër do ta kishte më të lehtë, sfidat janë për t'u tejkaluar e detyra ime e re është sfida e radhës, institucionet demokratike forcohen me angazhimin e pozitës, opozitës dhe shoqërisë civile.

Unë ju garantoj se do t'i përfaqësoj interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh bindjet politike. Institucioni të cilin e përfaqësoj do të garantojë unitet, stabilitet dhe jam tërësisht i dedikuar t'i shërbej këtij funksioni.

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Unë, si President i Republikës së Kosovës, do të jem gjithmonë me ju, pjesë e juaja dhe halleve tuaja, do të punoj dhe angazhohem që të jem pjesë e zgjidhjeve tuaja.

Do të punoj për të sotmen dhe të ardhmen e të gjithë qytetarëve të Kosovës: fëmijëve, të rinjve, prindërve dhe veteranëve të të gjitha kategorive.

Do të angazhohem me mundësitë dhe kompetencat e mia, për mirëqenie më të mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kosova ka mundësi për më shumë dhe më mirë.

Do të punoj për ruajtjen e integritetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, kjo është e shenjtë për ne, për barazinë në mes të shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera etnike, si dhe respektimin e të drejtave të të gjithë kosovarëve pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore apo racore, na kraju svi smo ravnopravni građani slobodnog, nezavisnog Kosova.

Do të punoj për një shtet të së drejtës dhe për një shtet ku askush nuk është mbi ligjin, do të mbështes fuqishëm luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duke siguruar pavarësinë e plotë të sistemit gjyqësor dhe kushtet optimale për punën e tyre.

Do të promovoj idenë për një Kosovë të hapur, e cila garanton lëvizje të lirë të njerëzve, të mallrave dhe shërbimeve, për një Kosovë të integruar plotësisht në shtëpinë e madhe evropiane, në NATO dhe organizatat e tjera globale.

Do të promovoj idenë për plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mënyrë që në të ardhmen presidenti i Kosovës të votohet nga vota e lirë e qytetarit.

Do të promovoj idenë e funksionalizimit të referendumi - referendumi është qelizë e demokracisë.

Do të promovoj idenë e ndryshimit të Ligjit zgjedhor, në mënyrë që në të ardhmen Kosova të ketë zgjedhje fer, zgjedhje të lira dhe korrekte.

Kosova ka qenë dhe mbetet vend, i cili respekton fqinjët dhe kryen obligimet e saj për marrëdhënie sa më të mira fqinjësore me të gjithë fqinjët e saj.

E falënderoj shumë Republikën e Shqipërisë dhe institucionet e saj, për kontributin e jashtëzakonshëm dhënë afirmimit të shtetit të Kosovës.

E çmoj lart gatishmërinë e Malit të Zi dhe Maqedonisë, për avancimin e raporteve të mira fqinjësore me Kosovën.

Për të gjithë strukturën politike në Kosovë është i rëndësishëm dialogu me Serbinë. Në këtë proces, Kosova do të prezantojë vlerat, idenë dhe vizionin për një fqinjësi të mirë, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe vlerësohen në mënyrë reciproke. Parimet e fqinjësisë së mirë janë bazë për integritet rajonale e më tutje për integritet global.

Do të punoj me gjithë qenien time që ta ngrejë Kosovën në mesin e shteteve të

respektuara dhe të vlerësuara të botës, në mesin e shteteve të respektuara me të ardhme të ndritur, atje ku qytetari është në qendër të vendimmarrjes dhe është esenca e qeverisjes.

Kosova e meriton këtë, kosovarët e meritojnë këtë. Kosovarët e meritojnë të jetojnë në vend me një të ardhme të ndritur dhe këtë mund ta arrijmë vetëm, e vetëm me përkushtim dhe me punë të ndershme.

Rol të veçantë në këtë proces ka rinia jonë. Për rininë kemi bërë pak, për rininë ne duhet të krijojmë kushte më të mira jetësore dhe një perspektivë të sigurt.

Me këtë mandat po hyjmë në fazën e re të shtetndërtimit të Kosovës, në fazën kur duhet të forcojmë fundamentet e shtetit të Kosovës, me vizion të qartë dhe pa frikë nga e ardhmja. Ne do të korrim sukses, këtë ju garantoj qytetarë të nderuar, sepse jemi të përkushtuar që suksesin ta arrijmë vetëm me punë profesionale dhe me nderë.

Prandaj, të dashur qytetarë të Kosovës dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës, së bashku t'ia fillojmë punës – jemi në vonesë.

Faleminderit edhe një herë dhe Zoti na ndihmoftë në këtë rrugëtim të përbashkët!
Zoti e bekoftë popullin e Kosovës,
Zoti i bekoftë të gjithë popujt në botë!
Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit!
Vazhdojmë me pikën e radhës. Pika e radhës është:

2. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë,
Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ia ka propozuar Kuvendit kandidatin për kryeministër të Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

(Duartrokitje)

I propozuari për kryeministër, zoti Hashim Thaçi, ka propozuar përbërjen e Kabinetit të Qeverisë, për miratim në Kuvend. Ftoj kandidatin e nominuar për kryeministër të Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë përbërjen e kabinetit të tij qeveritar.

HASHIM THAÇI:
I nderuar President i Republikës së Kosovës, z. Pacolli,
I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Krasniqi;
Të nderuar përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në Kosovë,

Të nderuar të gjithë ambasadorë,
I nderuar Peter Fait, zoti De Marnac, zoti Byler,
E nderuara Ulrike Lunacek,
Të nderuar deputetë të zgjedhur të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,
Unë do ta prezantoj fjalimin hyrës për formimin e Qeverisë së re, pastaj edhe pikat programore të programit qeveritar 2011/2014 dhe natyrisht pastaj edhe përbërjen e Qeverisë.

Me lejoni të filloj duke i uruar edhe një herë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për përvjetorin e tretë të pavarësisë së shtetit tonë dhe t'i uroj të gjithë deputetët për marrjen e përgjegjësive të reja.

Sot, me zgjedhjen e institucioneve të reja, legjitime, të Republikës së Kosovës, presidentit, Qeverisë, ne po i japim fund një maratone të padrejtë 5-6 mujore të një krize. Po i japim fund në një proces shumë legjitim dhe demokratik, në një proces me të cilin u përballëm të gjithë, gjithë qytetarët, të gjitha partitë politike, të gjitha institucionet. Falënderoj qytetarët për besimin e tyre, falënderoj edhe komunitetin ndërkombëtar për këshillat e tyre.

Themelet e shtetit tonë janë ndërtuar, për të mos u shembur kurrë më, prandaj Kosova ekziston sot dhe do të ekzistojë gjithmonë.

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
Unë njësoj sikur ju sot jam shumë i privilegjuar dhe falënderues e mirënjohës për qytetarët tanë të cilët na besuan që ne të jemi përfaqësuesit e tyre legjitim në tempullin e demokracisë të shtetit tonë. Dhe, natyrisht, bashkë me privilegjet, ne kemi përgjegjësi shumë të madhe, të cilat ne sot i pranuem njëzëri në momentin kur të gjithë dhamë betimin për respektimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ne të gjithë jemi të obliguar të respektojmë Kushtetutën tonë, e cila u mundëson qytetarëve tanë që të marrin frymë në mënyrë të barabartë para ligjit. Ai i mbron të drejtat dhe liritë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht përkatësisë etnike, religjionit apo bindjeve politike. Jemi të përkushtuar të ndërtojmë shtet demokratik dhe multi-etnik.

Për me tepër, vetë legjitimiteti i qeverisë sonë buron nga pajtueshmëria e çdo qytetari tonë për të qeverisur në mënyrë të drejtë.

Unë sot nuk dua të rikthej vëmendjen tuaj në ngjarjet të cilat bën që mandati ynë i mëparshëm të përmbillet një vit më herët.

Shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve të tilla janë të njohura për ju dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ju sot me votimin tuaj, si përfaqësues të zgjedhur të popullit të Kosovës e përmbillet atë cikël të pakëndshëm për Republikën e Kosovës.

Por, unë dua që t'iu rikujtoj të gjithëve se eksperiencia nga mandati i kaluar, duhet t'iu shërbejë të gjithë udhëheqëseve institucional si një mësim i mirë se çfarë nuk duhet të bërë në të ardhmen. Pra, të respektohet gjithmonë Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar dhe të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Besoj se të gjithë pajtohemi se muajt e fundit kanë qenë shumë sfidues jo vetëm për qeverinë e Republikës së Kosovës, por në tërësi për institucionet e vendit tonë.

Prandaj, unë e pranoj si krejtësisht legjitim shqetësimin e qytetarëve tanë, dhe ky shqetësim për mua do të shërbejë si një motiv shtesë që së bashku me ju të punojmë ta ndryshojmë tërësisht imazhin e shtetit tonë.

Kosova për shumë arsye po vazhdon të ballafaqohet me shumë sfida tjera sot, por do të ballafaqohet edhe në të ardhmen.

Edhe sot, është pikërisht një moment i tillë, i veçantë. Duke respektuar Kushtetutën tonë, ne po krijojmë institucionet tona të reja të fuqishme të cilat burojnë drejtpërdrejt nga vullneti i qytetarëve tanë, të cilat do t'i mbrojnë interesat e të gjithë qytetarëve.

Unë ju zotohem se do të bashkëpunoj me secilin deputet, partnerët e koalicionit, por edhe opozitën. Qytetarët e Kosovës duan participim në demokraci dhe jo bojkot të demokracisë.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Unë dua që edhe një herë t'iu falënderoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për besimin që ma kanë dhënë për të udhëhequr Qeverinë e Republikës së Kosovës në mandatin e ri katërvjeçar.

Unë shpreh përkushtimin tim më të sinqertë se me devotshmëri do t'iu shërbejë interesave të qytetarëve dhe vendit tim.

Mbi çdo interes tjetër, unë gjithmonë do të vë së pari interesin e Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Dhe, unë jam i bindur se edhe ju të gjithë të nderuar deputetë, e ndani të njëjtin qëllim me mua dhe se nuk do të kurseni: dijen, punën, përkushtimin në dobi të interesave tona nacionale.

Prandaj, edhe mesazhi im kryesor për ju të gjithë, e në veçanti për partitë opozitare, që për mua janë vlerë e demokracisë sonë parlamentare, është që të punojmë të gjithë së bashku për interes të Kosovës dhe qytetarëve tanë.

Deri më tani, Kosova ka qenë shembull i mirë në rajon, i participimit të gjithë spektrit politik në proceset demokratike.

Unë do të jem plotësisht i bindur se do të punoj me të gjitha partitë politike parlamentare dhe jo parlamentare, por edhe ato që nuk janë pra pjesë e jetës parlamentare këtu, por që kanë marrë pjesë në zgjedhje. Do të punoj shumë ngushtë edhe me shoqërinë civile, në interes të qytetarëve tanë, dhe do të ketë pjesë në kabinetin tim nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, sepse jam i përkushtuar dhe i zotuar që të ndërtoj qeveri që do t'i shërbejë të gjithë qytetarëve, jo vetëm një partie apo partive partnere të koalicionit, por për ndërtimin e një qeverie shumëpërfshirëse dhe gjithëtnike.

Të nderuar deputetë;
Zonja dhe zotërinj;

Si mandatar për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me lejoni të theksoj se partnerët e koalicionit qeverisës, Partia Demokratike e Kosovës, Koalicioni për Kosovën e Re, Lista “ Dr. Ibrahim Rugova”, Partia e Pavarur Serbe dhe Grupi” 6+”, konsiderojmë se katër vjetët e ardhshëm të mandatit qeverisës janë vendimtare për funksionimin dhe forcimin e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.

Nëse mandati ynë i parë ishte shpallja e Kosovës, shtet i pavarur dhe sovran, njohjet që arritën 75, numrin, konsolidimi i shtetit dhe forcimi i shtetit tonë, ne do të vazhdojmë tani me reformat e thella demokratike. Mandati i parë pra ishte mandati i pavarësisë e mandati i dytë do të jetë mandati i Kosovës evropiane.

Si rrjedhojë, ne jemi të përkushtuar për të përmbushur mandatin e plotë kushtetues të institucioneve të zgjedhura të Republikës së Kosovës, për të arritur zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe integrim në strukturat evro-atlantike.

Bazuar në këtë pikënisje, ne mbesin thellësisht të përkushtuar për një qeveri kredibile, efektive dhe të aftë për të forcuar më tej shtetin e pavarur të Republikës së Kosovës.

Për më tepër, ky program qeveritar që do të prezentohet, është një kondensim i prioriteteve dhe programeve të partive politike. Dhe, i falënderoj të gjithë ata që kanë punuar në këto prioritete, që janë pjesë përbëre të këtij koalicioni dhe nga shoqëria civile. Qeveria e Republikës së Kosovës, pra zotohet se do të ndjekë politikat të cilat janë, drejtpërdrejt që ndërlidhen me avancimin e integritit evro-atlantik të Kosovës dhe do të promovojnë raporte më të mira me shtetet fqinje;

- Të avancojmë më tej për përmbushjen e plotë të Planit Gjithëpërfshirës të Ahtisarit, duke përfshirë reformimin e pushtetit lokal, decentralizimin.

-Të promovojnë mirëqenien më të lartë ekonomike të të gjithë qytetarëve të Kosovës, bazuar në rritjen ekonomike të orientuar nga sektori privat i tregut të lirë ,me përqendrim në krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të hyrave. Për këtë qëllim, Qeveria është e përkushtuar për privatizimin asetëve të caktuara shtetërore në mënyrë

transparente; për zvogëlimin e rregullimit të tepërt qeveritar apo aktivitetit privat-ekonomik; implementimin e politikave tërheqëse investive; modernizimin e sektorëve të telekomunikimit dhe energjetik të vendit dhe revitalizimin e hovshëm të bujqësisë, teknologjisë dhe minierave duke e zhvilluar më tej infrastrukturën e tyre.

Unë, sot, të nderuar deputetë, qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës, do të shpaloj përpara jush vetëm disa nga pikat programore të Programit qeveritar 2011-2014, për shkak se ne do të kemi rastin që ta diskutojmë edhe në të ardhmen programin qeveritar në një nga seancat e ardhshme, apo edhe sot.

Programi qeveritar 2011-2014, i cili do të shërbej si udhërrëfyes i punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të mbetet një dokument i hapur për plotësime tjera të cilat konsiderohen si të domosdoshme për të avancuar interesat e shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Më lejoni që në vazhdim të shpaloj, pra shkurtazi pikat programore të Programit qeveritar 2011/2014.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Partnerët e koalicionit qeverisës janë pajtuar për programin qeverisës, i cili siguron që në katër vjetët e ardhshëm të mandatit qeverisës të Republikës së Kosovës, të arrihen rezultate të larta në ngritjen e efikasitetit dhe funksionimit demokratik të institucioneve të Kosovës.

Ne jemi të përkushtuar për të përmbushur mandatin e plotë kushtetues të institucioneve të zgjedhura të Republikës së Kosovës, për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, fuqizim të shtetit ligjor dhe integrim në strukturat evropiane. E ardhmja e Kosovës është në Bashkim Evropian edhe në mesin e vendeve të lira, të integruara dhe të zhvilluara, aty ku shkëmbehen dhe respektohen vlerat e mirëfillta të ekonomisë së tregut, të shoqërisë së hapur dhe institucioneve demokratike.

Gjatë tri vjetëve të kaluara, Qeveria e Republikës së Kosovës ka punuar me përkushtim maksimal për plotësimin e kriterëve të Kompenhagës në konsolidimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit, plotësimin e kriterëve ekonomike dhe harmonizimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian.

Sa i përket fuqizimit të administratës shtetërore, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur bazën ligjore për të reformuar administratën publike, proces ky shumë i rëndësishëm për përgatitjen e institucioneve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Procesi i integritit evropian është proces përplot sfida, por në tejkalimin e tyre Kosova nuk është e vetmuar, ka kapacitete. Gjatë dekadës që po e lëmë pas, Republika e Kosovës, ka pasur edhe mbështetje të fuqishme ndërkombëtare. Qeveria e Republikës së Kosovës për herë të parë ka vendosur bazat institucionale, një sistem të strukturuar dhe proaktiv të ndihmës së jashtme.

Programi ekonomik i Qeverisë, bazohet në parimet e ekonomisë së tregut, në konkurrencë të lirë. Ky vizion do të realizohet përmes mekanizmave të tregut me institucionet e shtetit si ndihmesë për të rregulluar sektorë të caktuar dhe për të garantuar mirëqenien sociale të qytetarëve. Identifikimi dhe shfrytëzimi i përparësive krahasuese të vendit, subjekteve ekonomike dhe resurseve humane si dhe optimalizimi i shfrytëzimit të këtyre resurseve, janë elemente përmbajtëse për mirëqenie dhe prosperitet ekonomik. Do të krijohet sistem vlerash, i bazuar në rregulla të qarta dhe transparente, prona dhe të drejta pronësore do të zënë vend të rëndësishëm në politikat tona. Do të shfrytëzohen në maksimum stimujt ekonomik të tregut dhe do të mundësohet qarkullimi i lirë i ideve, dijes dhe kapitalit.

Qeveria, në këtë mandat do të ruajë stabilitetin e gjithmbarshëm makroekonomik të vendit, do të sigurojë rritje të qëndrueshme ekonomike, zvogëlim të deficitit tregtar, ulje të papunësisë dhe shpërndarje adekuate të resurseve ekonomike.

Shteti i Kosovës ka perspektivë të qartë anëtarësimi në Bashkimin Evropian, ndërsa ky është angazhim dhe prioritet më i lartë i Qeverisë edhe në të ardhmen, anëtarësimi në BE, në një të ardhme sa më të afërt kohore, është bindje dhe orientim i qartë i qytetarëve të Kosovës. Për të zbatuar reformat e domosdoshme për integrim sa më të shpejtë të Republikës së Kosovës në Bashkim Evropian dhe në NATO, programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës do të bazohet në tri shtyllat kryesore: zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, qeverisje e mirë dhe fuqizim i sundimit të ligjit, mirëqenie sociale.

Qeveria e Republikës së Kosovës, e formuar nga partnerët e koalicionit dhe e hapur për bashkëpunim të plotë me opozitën, shoqërinë civile dhe të gjithë partnerët ndërkombëtarë, do të angazhohet për arritjen e ndryshimeve të domosdoshme në shoqëri dhe avancimin e qeverisjes së vendit, duke siguruar zhvillimin e institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës, i cili bazohet në rolin e Kuvendit të Kosovës, i cili siguron ligjshmërinë dhe llogaridhënien e të gjitha institucioneve dhe bartësve të funksioneve publike, forcimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe rritjen e ndjeshme të efektivitetit të tij, sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe të gjitha dukurive negative, përdorimin me përgjegjësi të lartë të parasë dhe pasurisë publike.

Zhvillim ekonomik, ndryshimin e strukturës së ekonomisë dhe nxitjes për të përshpejtuar zhvillimet ekonomike përmes politikave tatimore në kombinim me politikat tjera ekonomike.

Kompletimin e legjislacionit për tregun e letrave me vlerë dhe krijimin e kushteve për emetimin e tyre, ofrimin e një mjedisi biznesor që stimulon iniciativën e lirë ekonomike dhe investimet që mundëson krijimin e vendeve të reja të punës dhe zvogëlimin e varfërisë.

Në mbështetje të sektorit privat, do të implementohen projekte të veçanta, me qëllim të rritjes së eksportit si dhe programe për inkurajimin e ndërmarrësisë.

Do të ngrisim nivelin e shërbimeve të administratës dhe do t'i evitojmë pengesat administrative, në mënyrë që të stimulohet zhvillimi i papenguar i biznesit, si dhe të krijohen parakushte më të mira për tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Do të vazhdojmë me zbatimin rigoroz të politikës zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke fuqizuar rolin e Taskforcës Antikorrupsion, si dhe të gjitha institucioneve tjera relevante të sundimit të ligjit.

Në agjendën qeveritare me prioritet brenda një afati të shkurtër kohor do të adresohen edhe këto çështje, të nderuar deputetë, qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës:

Hartimi i një programi veprimesh të koordinuara për përmirësimin e imazhit të Kosovës dhe forcimin e pozicionit të saj në marrëdhënie ndërkombëtare.

Anëtarësimi në institucione dhe organizatat ndërkombëtare, rritjen e numrit të njohjeve të Republikës së Kosovës dhe lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me shtetet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makro-ekonomik dhe fiskal, duke përfshirë edhe menaxhimin e buxhetit të Kosovës, në pajtim me këto qëllime.

Vazhdimin e bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare për të siguruar qëndrueshmëri të financave publike.

Inicimin e aktiviteteve për hartimin e strategjisë për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Privatizimi mbetet si proces kyç në realizimin e reformave strukturore si dhe për forcimin e sektorit privat, si bartës kryesor i zhvillimit ekonomik.

Privatizimi i ndërmarrjeve të mbetura shoqërore dhe përmbyllja e procesit të likuidimit të tyre.

Vazhdimi i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në pajtim me ligjet në fuqi, praktikatat e avancuara ndërkombëtare: transparencën, llogaridhënien dhe interesin publik.

Procedimi i përshpejtuar i pakos legislative në funksionon të përmirësimit të ambientit biznesor.

Fillimin dhe zbatimin me sukses i regjistrimit të popullsisë, reformimi i legjislacionit të zgjedhjeve, duke filluar, siç e theksoi edhe presidenti, me zgjedhjen direkte të presidentit, gjithashtu edhe me reformën e thellë zgjedhore që duhet të ndodhë në vendin tonë. Dhe, në këtë drejtim, jam i përkushtuar dhe i vendosur që të fillojmë, natyrisht në një konsultim të ngushtë me të gjitha partitë politike, shoqërinë civile dhe praktikatat më të mira që i përgjigjen shtetit tonë dhe shoqërisë sonë.

Marrja e strategjisë për liberalizimin e vizave, gjithashtu, miratimi i kornizës së kurrikulumit të Kosovës, që do të sigurojë fuqizimin e cilësisë dhe komponentës edukative në shkolla, në pajtim me praktikën dhe standardet evropiane.

Hartimin dhe fillimin e zbatimit të një programi masash për përmirësimin e shpejtë të gjendjes në sistemin shëndetësor.

Ngritjen e mëtutjeshme të cilësisë së analizave dhe informatave mbi të cilat Qeveria mbështet politikën e saj me marrjen e vendimeve duke përfshirë avancimin e kapaciteteve të mëtutjeshme të Entit Statistikor të Kosovës.

Raportimin e vazhdueshëm mbi arritjen e objektivave programore që nënkupton vlerësimin e vazhdueshëm të performancës dhe ngritjen e efikasitetit.

Kompletimin e infrastrukturës së nevojshme ligjore për punën e Qeverisë e cila siguron konsistencë dhe harmonizim të politikave në shtyllat kryesore të punës së saj.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës.

Partnerët e koalicionit qeverisës janë të përkushtuar që të zbatojnë programin e përbashkët qeveritar, i cili është përpiluar duke marrë në konsideratë nevojat e vendit dhe interesat e qytetarëve tanë.

Për më tepër, ky program qeveritar është një harmonizim i prioritetëve dhe programeve të partive politike që janë pjesë përbërë e këtij koalicioni, por që do t'i shërbejë të gjithë qytetarëve.

Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet se do të ndjekë politikën e cilat:

- avancojnë integrimin evro-atlantik të Kosovës dhe do të promovojnë raporte më të mira me shtetet fqinje;

- Do të fillojë edhe dialogu Kosovë – Serbi, i cili do të përmbillet me njohjen reciproke të Kosovës për Serbinë si shtet dhe Serbisë për Kosovën si shtet, dialog ky për interesa praktike dhe jetë më të mirë të qytetarëve tanë, por edhe në interes të: paqes, stabilitetit, bashkëpunimit rajonal dhe integriteteve euroatlantike;

- Do të punoj për sundimin e ligjit, duke përfshirë përkushtimin tonë më të mirë të mundshëm për qeverisje të mirë. Natyrisht, do të kenë mbështetje të plotë organet e drejtësisë, në zvogëlimin e lëndëve të mbetura në gjykata, përmirësimin e qasjes në drejtësi për të gjithë qytetarët dhe zvogëlimin e mekanizmave alternativë për zgjidhjen e shpejtë të lëndëve civile.

- Të avancojnë më tej përmbushjen e Planit të Ahtisarit dhe përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrtur të Kosovës.

Ishte jashtëzakonisht inkurajuese kur të gjitha partitë politike, pra të gjithë deputetët e zgjedhur nga qytetarët e Kosovës dhanë betimin, i cili përfshihet në Kushtetutën e Kosovës, në dokumentin e presidentit Ahtisari.

Ne gjithashtu konsiderojmë se bashkëpunimi me partnerët tanë strategjik, si dhe asistenca teknike e tyre qoftë në mbështetje të investimeve publike ose ndihmën e drejtpërdrejt buxhetore, do të jetë e një rëndësie të veçantë në këtë periudhë për të mbështetur angazhimin e Qeverisë gjatë procesit të integritit evropian.

Ne jemi të përkushtuar që gjatë mandati të ardhshëm katërvjeçar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të fuqizojmë kapacitetin e përmbushjes së kriterëve të agjendës evropiane, ashtu që agjenda evropiane të shndërrohet në prioritet më të lartë të institucioneve dhe për agjendën evropiane duhet të punojmë të gjithë: Qeveria partnerët e koalicionit, opozita, shoqëria civile me mbështetje të plotë qytetare, duke involvuar dhe shfrytëzuar kontributin, pra të gjithë mekanizmave relevantë institucional dhe civilë të shoqërisë kosovare.

Duke punuar për procesin e liberalizimit të vizave të përfundojë në një afat sa më të shkurtër e të mundshëm kohor nga pranimi i strategjisë për viza nga Komisioni Evropian. Ne, në kohë rekorde do të meritojmë liberalizimin e vizave.

Kosova t'i plotësojë kushtet për nënshkrimin e marrëveshjes për marrëdhënie tregtare me Bashkimin Evropian. Hyrja në marrëdhënie kontraktuale me Bashkim Evropian, respektivisht nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim- Asocim dhe rrjedhimisht duke fituar statusin e vendit kandidat.

Kosova të jetë pjesë aktive dhe anëtare e barabartë e iniciativës së bashkëpunimit rajonal. Reformat e nevojshme për krijimin e institucioneve për një sistem të decentralizuar të fondeve të Bashkimit Evropian, vazhdimi i të qenurit faktor konstruktiv në rajon në lidhje me përkushtimin themelor të procesit të integritit, bashkëpunimit rajonal dhe fqinjësisë së mirë.

Për më tepër, Qeveria e Republikës së Kosovës do të ketë edhe objektivat dhe caqet në vijim:

Të mbështesë një rritje ekonomike të mjaftueshme për të gjeneruar vende të reja pune duke ulur papunësinë dhe nivelin e varfërisë;

Të zbatojë standarde ndërkombëtare për sigurim të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit dhe përfshirjes së plotë të gjeneratave të arsimin fillor, arsimin e mesëm dhe arsimin e lartë universitar;

Të ngrejë nivelin e shërbimeve shëndetësore ashtu që institucionet shëndetësore publike e private të ofrojnë shërbime sa më afër standardeve ndërkombëtare duke ulur nevojën në shërbimin e vendet e jashtme;

Të ngrejë nivelin e përkujdesjes sociale duke siguruar që fondet e destinuar të mbështesin nevojat e familjeve në varfëri të skajshme dhe personave me nevoja të veçanta;

Të stimulojë krijimtarinë kulturore, rrit rolin dhe pjesëmarrjen e rinisë në qeverisje e vendimmarrje, të zhvillojë dhe afirmojë sportin kosovar në vend dhe në arenën ndërkombëtare;

Të shtojë përkujdesjen institucionale për mërgatën, përkatësisht diasporën dhe rigjenerojë ndërlidhjet e tyre me përpjekjet për zhvillimin e tërësishëm të vendit;

Të rrisë sigurinë e qytetarëve, barazinë dhe liritë e të drejtat e qytetarëve dhe komuniteteve, lirinë e shprehjes dhe mediave, me përkushtim për kultivimin e mëtutjeshëm të tyre.

Të nderuar deputetë,

Ju të zgjedhurit e popullit të Kosovës,

Unë jam shumë i përgjegjshëm për punën time dhe e di që para veti kemi një punë shumë të madhe, shumë të përgjegjshme.

Unë së bashku me partnerët e koalicionit qeverisës, presidentin e mbi të gjitha Parlamentin, do të ndërtojmë një kabinet qeveritar të aftë, kredibil, kompetent për të zbatuar programin e qeverisë sonë, e programi i qeverisë sonë është programi i reformave të thella demokratike, është programi i Kosovës evropiane, është programi i liberalizimit të vizave, e në këtë mandat katërvjeçar i anëtarësimit të Kosovës në NATO dhe respektimi i plotë i të gjitha marrëveshjeve të premtuara nga ana ime me të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare.

Kam besim të madh në ekipin e propozuar, në aftësitë e tyre profesionale dhe përkushtimin për t'i shërbyer gjithë qytetarëve.

Prandaj, të nderuar deputetë, të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, të nderuar miq ndërkombëtarë, në vazhdim më lejoni të lexoj përbërjen e Kabinetit apo prezantojë përbërjen e Kabinetit të ri qeveritar.

Qeveria e Republikës së Kosovës, do të ketë pesë zëvendëskryeministra:

- Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Drejtësisë;
- Mimoza Kusari, zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë;
- Slllobodan Petroviq, zëvendëskryeministër dhe ministër për Qeverisje Lokale;
- Edita Tahiri, zëvendëskryeministre;
- Bujar Bukoshi, zëvendëskryeministër;

Ministria e Jashtme, Enver Hoxhaj,

Ministria për Integritet Evropian, Vlora Çitaku;

Ministër i Forcës së Sigurisë, Agim Çeku;

Ministër i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi;

Ministër i Financave, Bedri Hamza;

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Memli Krasniqi;

Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj;

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja;

Ministria e Administratës Publike, Mahir Yagcillar;

Ministria e Infrastrukturës, Fehmi Mujota;

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Blerand Stavileci;

Ministria e Shëndetësisë, Ferid Agani;

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq,

Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Dardan Gashi, dhe

Ministria për Kthime dhe Komunitete, Tomiq Radojica.

Të nderuar deputetë,

Unë ju ftoj që të votoni kabinetin e ri qeveritar duke qenë thellësisht i bindur se ne së bashku do të punojmë me nder, përkushtim dhe profesionalizëm për interesat e qytetarëve të vendit tonë.

Ju faleminderit, paraprakisht për mbështetjen tuaj.

(Duartrokitje)

KRYTARI I KUVENDIT: A ka të interesuar për debat?

Fjalën e ka deputetja Rada Trajković.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovana gospodo poslanici,

Mislim da svi zajedno treba da shvatimo da Jedinствена srpska lista ušla je u Parlament Kosova i Metohije da zajedno sa svim poslanicima gradi bolju budućnost za sve stanovnike ovoga prostora, koji zaista u prošlosti je imao jako, jako mnogo problema i da radimo na nečemu što jesu projekti pomirenja.

Moram da vam kažem da kandidat, gospodin Hašim Tači ne nudi budućnost ni jednima ni drugima ili u opšte stanovništvu Kosova i Metohije iz dva vrlo relevantna razloga,

jednog formalnog a drugog moralnog. Formalnog, zato što smo imali izbore koje se ne pamte u svetu, dva meseca mi ne možemo da sklopimo izborne rezultate zbog nepravilnosti, da ne kažem krađe koju je na najdirektniji način promovisao lider Demokratske partije Kosova, gospodin Tači sa svojom partijom, normalno uz svoje satelite koji se, na žalost, neki od njih nalaze i u Parlamentu, tu mislim i na Samostalnu liberalnu stranku.

Iz moralnog razloga, zato što je u Parlamentu Saveta Evrope gospodin Dick Marty označio gospodina Hašima Tačija i „Dreničku grupu“ kao nosioce nečega što podrazumeva trgovinu organima i što podrazumeva kriminal, i što podrazumeva sve ono što ga ne preporučuje za premijera.

Moram još nešto da vam kažem. Ja mislim sve dok gore gledamo komandanta KFOR-a, sve dok gore sedi šef EULEX-a i gospodin Piter Feit, prostor Kosova i Metohije nema nezavisnost i nije nezavistan. Nema suverenitet. I mi kada smo se zakleli, mi smo se zakleli na zajednički rad sa Albancima, na zajedničku budućnost sa ljudima čistih ruku i čistog obraza. Tako da ja u ime preko šest hiljada srpskih birača i preko 50 ljudi koji su bili na listi Jedinственe srpske liste, neću glasati jer mislim da je ovo propast za prostor Kosova i Metohije. Ne očekujem i ne verujem da će bilo ko ulagati u prostor na čijem čelu se nalazi čovek sa onim što je Dick Marty u Političkom komitetu Saveta Evrope dobio podršku ne nekoliko država, nego gotovo čitavog Evropskog parlamenta.

I na kraju, gospodine predsedniče Skupštine, želim da vas zamolim da me dočekuju pred mog imena identifikacija koja me neće me identifikovati kao „zonju“, nego će me identifikovati kao Radu Trajković. Dakle, diskriminacija i albanizacija srpskog imena i prezimena i naziva da ne bude realnost. Hvala velika!

KRYETARI: Zonja deputete, e bëjmë korrigjimin dhe e shënojmë krejt në gjuhën tënde, në gjuhën serbe.

Po vazhdojmë. Nëse keni për të thënë diçka, pa replikë, mund ta merrni fjalën, për replikë, vazhdojmë...

Lus deputetët...

(Duartrokitje)

Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa. Sido që të thuhet, Republika e Kosovës është shtet dhe mund të thuhet, po edhe ata e dinë që s'është ashtu, mos u bëni merak shumë!

(Qeshje në sallë)

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës,

I nderuar president,

I nderuar kandidat për kryeministër,

Unë mendoj se sot ne kemi arritur një rezultat të mirë të formojmë institucionet për arsye se vazhdimi i Kosovës më tutje me një vakum institucional do të çonte në kriza edhe më të thella se sa që i ka shoqëria jonë. Prandaj, këtë unë e konsideroj si një moment shumë

të rëndësishëm, prandaj të gjithë kolegëve deputetë dhe presidentit të zgjedhur deri tani dhe kabinetit që do të zgjedhet, iu uroj suksese!

Unë desha të them diçka lidhur me dokumentin që e morëm sot – Programin e Qeverisë, për arsye se është një dokument shumë i rëndësishëm dhe unë besoj që ne sot sigurisht nuk do të kemi mundësi ta aprovojmë atë program për arsye se ai do të duhej të diskutohej në një mbledhje të Qeverisë, ku do të harmonizohej më mirë, ndonëse në program shkruan se partnerët e koalicionit janë pajtuar për këtë program, mendoj se partnerët e koalicionit nuk kanë pasur mjaft kohë ta diskutojnë dhe të pajtohen për të gjitha detajet që duhet të pajtohen, në mënyrë që ky të jetë një program konsistent, një program i cili me punën e Qeverisë do ta nxjerr... me punën e Qeverisë dhe me punën e Kuvendit dhe të presidentit, i cili sigurisht do ta ketë agjendën e vet, do ta nxjerrë Kosovën nga kriza e thellë.

Në këtë drejtim, unë dëshiroj të them vetëm disa fjalë. Ka disa fusha që duhet të përpunohen me kujdes. Së pari, në këtë program ne nuk kemi asnjë cak të përkufizuar me numra, çfarë do të jetë rritja ekonomike, çfarë do të jetë buxheti, çfarë do të jetë punësimi, çfarë do të jetë eksporti, çfarë do të jetë importi. Unë e di se dikush mund të frikohet nga zotimet me shifra dhe zotimet precize, por askush nuk duhet të frikohet. Qytetarët na e kanë dhënë besimin, na e kanë dhënë votën dhe ne duhet t'i tregojmë ato këtu, në mënyrë që të matet performanca jonë, sepse ky Kuvend ka të gjitha autorizimet, ka kapacitetet dhe ka përgjegjësitë që të matë performancën dhe të marrë masa, sepse nëse matja e performancës, përgjegjësia dhe llogaridhënia nuk ndodhin me të vërtetë, por vetëm është deklarative, kriza do të thellohet, kriza do të thellohet. Nuk mund të kemi program qeverisës i cili nuk e ka asnjë paragraf për buxhetin e Kosovës. Ne e dimë, ne e dimë çfarë është situata me buxhetin e Kosovës, e dimë çka na pret. Prandaj, unë kërkoj sot nga deputetët e Kuvendit që të obligojnë Qeverinë që bashkë me projektin për buxhet të na bie edhe një program konsistent me të gjithë parametrat, me të gjitha caqet, në mënyrë që ky parlament dhe votuesit të jenë në gjendje të matin performancën e këtij kabinetit.

Unë gjej në përbërjen e kabinetit shumë njerëz me kredibilitet dhe njerëz të cilët e meritojnë votën e qytetarëve. Por, ka edhe të tillë që nuk janë treguar vigjilentë në zbatimin e ligjshmërisë, zbatimin e kushtetutshmërisë, demokratizimit, prandaj kjo do të duhej të jetë vërejtje. Ata mund të kenë ndërruar resorët, por bashkë me resorët duhet t'i ndërrojnë edhe shprehjet. Ju faleminderit dhe kërkoj që të bashkëpunojmë në dobi të qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! A dëshiron ndokush fjalën? Jo, unë po kam dëshirë të mos ankohet dikush pse s'ia kam dhënë fjalën, nëse e do dikush fjalën, le ta marrë. Mirë, faleminderit! Këto diskutime pak a shumë ishin si një lloj opozite dhe mirë bënë. Vazhdojmë.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për Kabinetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Sa deputetë i kemi në sallë? Ftoj deputetët të cilët nuk janë në sallë, e që ishin deri tani, të kthehen!

Në sallë kemi 66 deputetë. Votojmë!
Kush është për Kabinetin qeveritar? Faleminderit!
A ka kundër? Një kundër. Faleminderit!
A ka abstenim?
Konstatoj se me 65 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës.

(Duartrokitje)

Ftoj kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat t’i zënë vendet e tyre!

Vazhdojmë, vazhdojmë seancën! Hajde, urime, urime! Urime! Urime edhe juve!

Ju ftoj juve, Kabinetin e ri qeveritar, që të ngriheni në këmbë, pasi kryeministri duhet lexojë tekstin e betimit. Derisa kryeministri e lexon tekstin, ju qëndroni në këmbë, po edhe kryeministri në këmbë, gjithashtu.

KRRYEMINISTRI I KOSOVËS HASHIM THAÇI: “Ne, anëtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, betohemi solemnisht se me përgjegjësi, me përkushtim dhe me ndershmëri do t’i kryejmë të gjitha detyrat dhe punët që i kemi sipas mandatit të dhënë nga ky Kuvend, gjithmonë duke zbatuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjin dhe vendimet e miratuara, duke respektuar parimet, normat dhe standardet ndërkombëtare për liri, barazi, demokraci, në interes të përparimit ekonomik, arsimor, kulturor e të gjithëmbarshtëm të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës”. Betohem!

KRYETARI I KUVENDIT: Ju lus, do të thotë, kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar, që ta nënshkruani betimin dhe pastaj ta marrë Administrata e Kuvendit. Zoti kryeministër, mund t’i drejtohesh edhe seancës, edhe opinionit me një fjalë rasti.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar president Pacolli,
I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, urime përgjegjësitë e reja!
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ju të zgjedhurit e popullit të Kosovës,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar ambasadorë,
I nderuar zoti Piter Feit,
Gjithashtu, i nderuar zoti Byhler, zoti Marnjak, të gjithë ju miq ndërkombëtarë që jeni sot prezentë,

Ju përshëndes tani si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës me përgjegjësinë më të lartë se ne do të vazhdojmë të punojmë me përgjegjësitë tona të shtuara për Kosovën evropiane, në shërbim të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ju falënderoj juve, deputetë të nderuar, për besimin tuaj, i falënderoj të gjithë qytetarët e

Republikës së Kosovës për besimin e tyre në vizionin tim për të ardhmen e Kosovës dhe ekipit tim që është këtu pranë meje. Unë zotohem se do t'u shërbej të gjithë qytetarëve të vendit, do të kem bashkëpunim të ngushtë në interes të vendit me të gjitha partitë politike, shoqërinë civile, me gjithë faktorët relevantë të shoqërisë kosovare. I falënderoj për mbështetje të gjithë komunitetin ndërkombëtar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet e Bashkimit Evropian, ICO-në, zotin Piter Feit, zotin Byhler, gjithashtu edhe me autoritetet e EULEX-it, zotin Marnjak, për bashkëpunimin që do ta kemi edhe në të ardhmen, duke i falënderuar gjithmonë për bashkëpunimin edhe në të kaluarën, prandaj ne sot e përmbyllim një proces maratonik, sot i hapëm një rrugë të re Kosovës, një kapitull të ri, kapitullin e Kosovës evropiane zhvillimore dhe atë të reformave. Ju faleminderit, edhe një herë! Thank you very much!

KRYETARI I KUVENDIT: I nderuari president, edhe pse nuk qenka këtu, I nderuari kryeministër, I nderuari kabinet qeveritar, urime për detyrat që i morët sot nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që më parë i keni marrë nga qytetarët e Kosovës. Urime edhe qytetarëve të Kosovës!

Dhe, me këtë e mbyllim seancën e sotme plenare.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve